



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1622/4 prot.

Tiranë më 20.12.2018

REKOMANDIM

Nr. 29, datë 20.12.2018

PËR KONTROLLUESIN "INTERNATIONAL HOSPITAL" SH.A

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "International Hospital" sh.a.,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 286 datë 09.11.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "International Hospital" sh.a (ish Spitali Hygeia), me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasja D.Xh, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga shtetësja me iniciale D.Xh, lidhur me pretendimin e mosdhënies të kopjes së kartelës mjekësore nga spitali.

Kontrolluesi "International Hospital" sh.a ushtron aktivitet në fushën e shëndetësisë duke ofruar shërbime mjekësore të ndryshme dhe në këtë kuadër përpunon të dhëna personale/sensitive kryesisht për kategorinë e subjekteve të të dhënave "pacientë" por edhe për "punonjësit". Kontrolluesi i përpunon të dhënat në mënyrë manuale nëpërmjet kartelave mjekësore të pacientëve të cilat administrohen nga stafi mjekësor dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet pajisjeve dhe programeve mjekësore.

Nga hetimi administrativ u konstatua se kërkesa për akses nuk është mohuar nga kontrolluesi (International Hospital sh.a).

Megjithatë, gjatë hetimit administrativ u konstatua se nga kontrolluesi "International Hospital" sh.a nuk ishin përcaktuar rregulla të detajuara dhe të qarta për kategoritë e të dhënave personale që përpunohen nga ky spital.

Në kuadër të garantimit të sigurisë së të dhënave personale, kontrolluesi ka hartuar "Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale" mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të pacientëve dhe punonjësve, por në përmbajtje të saj Zyra e Komisionerit konstaton mangësi sa i përket parashikimit të rregullave specifike lidhur me afatin e mbajtjes së të dhënave personale për çdo kategori të subjekteve të të dhënave personale, tërësinë e të drejtave që gëzojnë subjektet e të dhënave personale në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Kontrolluesi në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, konsiderohet si një kontrollues i rëndësishëm, për shkak të sasisë së konsiderueshme të informacionit që përpunon dhe kategorisë sensitive të të dhënave personale që përpunon.

Lidhur me konstatimet e evidentuara nga hetimi administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e kontrolluesit për të marrë masat e nevojshme për sigurinë e të dhënave personale, sipas parashikimit në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm hartimin korrekt dhe të plotë të rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi këto akte përbëjnë bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcaktojnë standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "International Hospital" sh.a është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë, dhe ka argumentuar se ankuesja ka qënë out-patient, dhe është paraqitur pranë spitalit vetëm për ekzaminime e analiza, të cilat i janë vënë në dispozicion.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 27, 29, 30 dhe 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar;

REKOMANDUJ:

1. Kontrolluesi "International Hospital" sh.a, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar të përmirësojë Rregulloren për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale".
2. Kontrolluesi "International Hospital" sh.a, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar të ketë në vëmendje përmirësimin e vazhdueshëm të masave teknike dhe organizative për të garantuar përpunimin e sigurt të të dhënave personale gjatë ofrimit të shërbimeve.
3. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 20.12.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

